

EKSPLORIMI I PËRVOJAVE TË PSIKOLOGËVE SHKOLLORË NË KOSOVË

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIMI

nga

QENDRESA DALIPI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË

Prishtinë

Korrik, 2026

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Liridona Jemini-Gashi

Psikologët shkollorë kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe akademike të nxënësve, përmes ofrimit të shërbimeve të vlerësimit, këshillimit, ndërhyrjeve parandaluese dhe bashkëpunimit me mësimdhënësit, prindërit dhe institucionet përkatëse (NASP, 2020; Merrell et al., 2012). Në vitet e fundit, rëndësia e këtij profesioni është rritur si rezultat i shtimit të nevojave për mbështetje psikologjike në shkolla, ndërsa njëkohësisht psikologët shkollorë përballen me sfida të shumta, si ngarkesa e lartë në punë, paqartësia e rolit profesional, mungesa e mbështetjes institucionale dhe zhvillimit profesional (Jimerson et al., 2007; Fagan & Wise, 2007; Suldo et al., 2010). Në Kosovë, literatura mbi përvojat profesionale të psikologëve shkollorë mbetet e kufizuar, duke e bërë të nevojshëm eksplorimin e perceptimeve të tyre mbi rolin, sfidat dhe nevojat profesionale.

Qëllimi i këtij punimi është të eksplorojë përvojat profesionale të psikologëve shkollorë në Kosovë, duke analizuar perceptimet e tyre mbi rolin profesional, sfidat me të cilat përballen, bashkëpunimin me akterët e tjerë të sistemit arsimor, ndikimin e punës së tyre në zhvillimin emocional dhe akademik të nxënësve, si dhe nevojat për zhvillim profesional dhe mbështetje institucionale. Studimi synon të ofrojë një kuptim më të thelluar të realitetit profesional të psikologëve shkollorë dhe të identifikojë faktorët që ndikojnë në efektivitetin e punës së tyre.

Studimi është realizuar duke përdorur një qasje kualitative me dizajn eksplorues. Mostra përbëhej nga gjashtë psikologë shkollorë të shkollave publike fillore dhe të mesme në Komunën e Prishtinës, të përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme. Të dhënat u mblodhën përmes intervistave gjysmë të strukturuar, të cilat u regjistruan, u transkriptuan dhe u verifikuan nga pjesëmarrësit. Analiza e të dhënave u realizua përmes analizës tematike sipas Braun dhe Clarke (2006), duke identifikuar temat dhe modelet kryesore që karakterizojnë përvojat profesionale të psikologëve shkollorë.

Gjetjet nga studimi identifikuan pesë tema kryesore. Së pari, psikologët e perceptojnë rolin e tyre si shumëdimensional dhe thelbësor për funksionimin e shkollës, megjithëse shpesh ai mbetet i paqartë dhe keqkuptohet nga stafi shkollor. Së dyti, ngarkesa e lartë në punë, raporti i madh psikolog–nxënës dhe detyrat administrative ndikojnë negativisht në cilësinë e shërbimeve dhe rrisin rrezikun për djegie profesionale, në përputhje me literaturën ekzistuese (NASP, 2020; Maslach & Leiter, 2016). Gjithashtu, bashkëpunimi me mësimdhënësit dhe prindërit u vlerësua pozitivisht, ndërsa bashkëpunimi me institucionet e jashtme rezultoi më pak funksional.

Psikologët raportuan se problematikat më të shpeshta të nxënësve lidhen me ankthin, vështirësitë emocionale, problemet në sjellje dhe vështirësitë në të nxënë, ndërsa fenomenet si dhuna kibernetike dhe vetëlëndimi po bëhen gjithnjë e më të pranishme. Një tjetër gjetje e rëndësishme ishte mungesa e trajnimeve të vazhdueshme, supervizimit profesional dhe mbështetjes institucionale, të cilat konsiderohen faktorë kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve psikologjike.

Punimi mbështetet në Teorinë Bioekologjike të Sistemeve të Bronfenbrenner-it (1979), e cila shërben si kornizë teorike për interpretimin e ndikimit të faktorëve individualë, institucionalë dhe shoqërorë në përvojat profesionale të psikologëve shkollorë. Kjo qasje mundëson një kuptim gjithëpërfshirës të ndërveprimit ndërmjet psikologëve, nxënësve, familjeve, shkollave dhe politikave arsimore.

Bazuar në studim mund të konkludohet se psikologët shkollorë luajnë një rol të pazëvendësueshëm në promovimin e mirëqenies dhe zhvillimit të nxënësve, por efektiviteti i punës së tyre kufizohet nga faktorë organizativë dhe institucionalë. Gjetjet tregojnë nevojën për qartësimin e rolit profesional, uljen e raportit psikolog–nxënës, forcimin e bashkëpunimit

ndërinstitucional, krijimin e mekanizmave të rregullt të supervizimit dhe zhvillimit profesional, si dhe përfshirjen më aktive të psikologëve në hartimin e politikave arsimore.

Kontributi shkencor i këtij studimi qëndron në pasurimin e literaturës shqiptare mbi psikologjinë shkollore dhe në ofrimin e evidencave empirike mbi realitetin profesional të psikologëve shkollorë në Kosovë. Gjetjet e studimit mund të shërbejnë si bazë për hartimin e politikave arsimore, përmirësimin e organizimit të shërbimeve psikologjike në shkolla, fuqizimin e rolit të psikologut shkollor dhe zhvillimin e programeve të vazhdueshme të trajnimit dhe supervizimit profesional. Në këtë mënyrë, studimi kontribon jo vetëm në zhvillimin e praktikës profesionale të psikologëve shkollorë, por edhe në përmirësimin e cilësisë së mbështetjes psikologjike dhe të mirëqenies së nxënësve në sistemin arsimor të Kosovës.